



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Kuvendi Komunal
i Deçanit

01Nr ____ Dt: __/__/2016

Në bazë të dispozitave të nenit 12 pika 12.2, nenit 40 pika 40.2 paragrafi(g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 2 pika 2.1 nenit 8 dhe nenit 13 pika 13.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, nenit 25 pika 10 e Statutit të Komunës së Deçanit .
Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt: __/__/__ miratoi:

PROPOZIM

RREGULLORE

(Për Lartësinë e Taksave, Ngarkesave, Tarifave dhe Gjobave Komunale)

PËRKUFIZIMET

Neni1

-**“Taksë”**- do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumentet, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialet e nevojshme.

-**“Gjobjë”**- do të thotë një pagesë e cila duhet të bëhet në rast të shkeljes së një ligji, rregulle ose rregullore komunale. Në përgjithësi, gjobat shqiptohen me qëllim të dënimit të një shkelje dhe duhet të shqiptohen në përputhje me shumat e përcaktuara në skemat fikse të cilat zbatohen për shkeljet e legjislacionit komunal.

-**“Tarifë”**- ka kuptimin e shumës e cila paguhet për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, për shërbimet profesionale, për pronësinë e automjeteve etj..

-**“Ngarkesë”**- ka kuptimin e shumës e cila paguhet në emër të ndërtimit apo rrënimin të objekteve, shfrytëzimit të burimeve natyrore, të hyrat nga qiradhënia dhe nga gjobat e trafikut.

-**“Viti fiskal”**- do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit;

-**“Rregullore Komunale”**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.

-**“Prona komunale”**- nënkupton pronën, duke përfshirë pronën e paluajtshme, e cila është ligjërisht në pronësinë ose ligjërisht nën administrimin e komunës.

-**“Llogari zyrtare bankare”**- ka kuptimin e përcaktuar në LMFPP.

QËLLIMI

Neni 2

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e taksave, tarifave dhe ngarkesave për shërbimet nga veprimtaritë komunale në territorin e komunës së Deçanit, që duhet t'i paguajnë personat fizikë dhe juridikë në emër të shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare, tarifave për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit dhe tarifave për shërbime profesionale, pronësisë së automjeteve motorike, përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrave nga qiradhënia dhe gjobat nga trafiku.

Neni 3

3.1. Pagesa për kryerjen e shërbimeve administrative Komunale, bëhet në Valutë e cila është e aplikueshme si mjet pagese në Kosovë.

3.2. Xhirollogaria e Komunës së Deçanit është

Lirimi nga Taksat, Ngarkesat dhe Tarifat

Neni 4

Nga pagesa e taksës administrative lirohen grupet e caktuara si dhe, në bazë të subjektit të kërkesës.

4.1. Përgjithësisht nga pagesa e taksës administrative lirohen:

- a). Organet lokale, regjionale, qeveritare të Republikës së Kosovës si dhe organet e tyre, të cilat adresojnë kërkesa zyrtare;
- b). Institucionet publike në fushat e: fëmijëve parashkollorë, arsimit, shkencës, kulturës, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, shëndetit, mirëqenies sociale, për kërkesat/aktivitetet e tyre.
- c). Rastet sociale, invalidët civil dhe personat me nevoja të veçanta.
- d). Invalidët e luftës, veteranët, viktimat të luftës si dhe, familja e ngushtë e dëshmorëve, viktimave civile dhe të zhdukurve të UÇK-së. (sipas Ligjit Nr. 04/L-172 dhe Ligjit Nr. 04/L-054)

4.2. Nga pagesa e taksës administrative gjithashtu lirohen:

- a). Peticionet, ankesat dhe propozimet drejtuar institucioneve komunale dhe organeve tjera publike;
- b). Dokumentet dhe veprimet në procedurën e korrigjimit të gabimeve të bëra nga zyrtarët përgjegjës komunal në vendime, dokumente dhe regjistra zyrtarë;
- c). Dokumentet dhe shërbimet për të cilat lirimi i pagesës është rregulluar me rregulloret ose vendimet komunale të specifikuara për shërbime të caktuara;
- d). Vërtetimi mbi pranimin e kërkesës apo lëndës;

4.3 Nëse procedura është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave, atëherë taksa administrative paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa. .

4.4. Nëse vendimi apo dokumenti lëshohet pa pagesën e taksës administrative atëherë shkresa e bashkangjitur duhet të tregojë qëllimin e dhënies dhe bazën e përjashtimit nga pagesa..

Neni 5

Burimet e të hyrave vetanake komunale në përputhje me legjislacionin në fuqi janë:

1. Tatimi në pronën e paluajtshme
2. Ngarkesat për shërbimet Komunale
3. Tarifat për shërbimet e Administratës Komunale
4. Gjobat ne Trafik dhe gjobat për shkeljen e Rregulloreve Komunale dhe
5. Të hyrat tjera te lejuara sipas dispozitave Ligjore

Kapitulli II DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 6

Taksat, Ngarkesat ,Tarifat dhe Gjobat Komunale, me këtë rregullore përcaktohen sipas lëmive përkatëse dhe strukturës organizative te administratës, duke përfshirë numrin rendor si dhe vlerën përkatëse.

Neni 7

Drejtoria për Administratë te Përgjithshme

Tarifa nr. 1

Nr		Shuma/ €
1	Për çdo kërkesë të parashtruar	0.50 €
2	Për aplikacion pjesëmarrje në konkurs	1.00 €
3	Certifikata e lindjes	1.00 €
4	Ekstrakt i lindjes	1.00 €
5	Certifikate e shtetësisë	1.00 €
6	Certifikate e martesës	1.00 €
7	Certifikate e banimit	1.00 €
8	Certifikate e gjendjes martesore	1.00 €
9	Deklarate e bashkësisë familjare	1.00 €
10	Procedura e kurorëzimit në objektin e komunës gjate orarit zyrtar	10.00 €
11	Procedura e kurorëzimit në objektin e komunës jashtë orarit zyrtar	20.00 €
12	Procedura e kurorëzimit jashtë selisë gjatë orarit zyrtar	50.00 €
13	Procedura e kurorëzimit jashtë selisë dhe jashtë orarit zyrtar	70.00 €
14	Për aktvendimin e lëshuar për ndryshimin në statusin civil	5.00 €
15	Kërkesë për martese me shtetas të huaj	10.00 €
16	Regjistrimi i martesave të qytetareve të Kosoves i kryer ne shtete tjera	0.0 €
17	Regjistrimi i vdekjes	0.0 €
18	Regjistrimi i mëvonshëm ne regjistrin e të vdekurve (pas 30 ditësh)	50.00 €
19	Regjistrimi i vdekjes i ndodhur jashtë Kosovës	0.0 €
20	Certifikate e vdekjes	1.00 €
21	Dëshmi e vdekjes	0.0 €
22	Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës	10.00 €
23	Legalizimi i nënshkrimit	1.00 €
24	Legalizimi i kopjeve në baze të origjinalit	0.50 €
25	Verifikim i dokumenteve të ndryshme nga shtete të tjera	2.00 €
26	Pajisja me dokumente nga arkiva	2.00 €
27	Kërkesë për fitimin e shtetësisë me lindje në Kosove	50.00 €

28	Kërkesë për fitimin e shtetësisë në lindje jashtë Kosove ku njeri prind është shtetas i Kosovës	50.00 €
29	Kërkesë për fitimin e shtetësisë me natyralizim dhe me natyralizimin e bashkëshortit	150.00 €

Taksat tjera të realizuara nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme janë të përcaktuara nga udhëzimet administrative të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe si të tilla do të realizohen.

Neni 8

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Tarifa Nr .2

2. 1 Për dhënien e kushteve të lokacionit brenda planit rregullues:

Nr.		Shuma/€
1	Për objekte individuale të banimit	10.00 €
2	Për objekte kolektive të banimit	20.00 €
3	Për objekte ekonomike industriale	20.00 €
4	Për objekte përcjellëse-garazhë, posllom, muri etj. në kuadër të ngas. kadastrale	10.00 €
5	Për objekte të përziera-banimit dhe afarizëm	20.00 €
6	Për objekte afariste	30.00 €
7	Për objekte publike	15.00 €
8	Për objekte bujqësore	15.00 €

2.2. Për dhënien e kushteve të lokacionit jashtë P.Rr. me vëzhgim në vend të ngjarjes:

Nr.		Shuma/€
1	Për objekte individuale të banimit	10.00€
2	Për objekte kolektive të banimit	30.00€
3	Për objekte ekonomike industriale	30.00€
4	Për objekte të përziera-banim dhe afarizëm	25.00€
5	Për Objekte afariste	50.00€
6	Për objekte publike	25.00 €
7	Për Objekte bujqësore	25.00€

2.3. Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme

Nr.		Shuma/€
1	Për objekte të përkohshme montuese:baraka,kioske,garazha e tj. në sipër. publike.	15.00€
2	Për objekte të përkohshme montuese:baraka,kioske,garazha e tj. në sipër. Private	10.00€
3	Për objekte afariste-ekonomike e tj.(depo, servise, magazina e tj.)	25.00€
4	Për objekte lëvizëse frigorifer, aparate, tavolina etj	10.00€

2.4. Për dhënien e lejes urbanistike:

Nr.		Shuma/€
-----	--	---------

1	Brenda Planit Rregullues	20.00€
2	Jashtë Planit Rregullues	30.00€

2.5. Për caktimin e vijës së ndërtimit dhe asaj të rregullimit

Nr.		Shuma/ €
1	Për objekte të banimit.(individual dhe kolektiv)	20.00 €
2	Për objekte afariste-ekonomike industriale	50.00 €
3	Për objekte të përkohshme montuese	25.00 €
4	Për Objekte bujqësore	25.00 €

2.6. Për dhënien e lejes së përdorimit (shfrytëzimit) te objekteve:

Nr.		Shuma/€
1	Për objektet e banimit deri 1000 m ²	50.00€
2	Për objektet e banimit prej 1000-5000 m ²	100.00€
3	Për objektet e banimit mbi 5000 m ²	150.00€
4	Për objekte afariste-ekonomike-industriale deri në 1000 m ²	100.00€
5	Për objekte afariste-ekonomike-industriale prej 1000 m ² -5000 m ²	150.00€
6	Për objekte afariste - ekonomike - industriale mbi 5000 m ²	100.00€
7	Për objekte të përkohshme montuese	20.00€
8	Për objekte publike me sipërfaqe deri ne 1000 m ²	50.00€
9	Për objekte publike me sipërfaqe mbi 1000 m ²	80.00€
10	Për Objekte bujqësore	25.00€

2.7. Për vizitë në vend të ngjarjes sipas kërkesës së palës:

Nr.		Shuma/€
1	Dhënia e vërtetimit mbi vjetërsinë - gjendjen e objektit	20.00€
2	Konstatimi i komisionit lidhur me zgjerimin e objektit ekzistues pas aprovimit	25.00€

2.8. Përpunimi i lëndës sipas kërkesës së palës:

Nr.		Shuma/€
1	Përpunimi, përcjellja e lëndëve-kërkesave, ankesave, prapismeve lëshimi i vërtetimeve në bazë të dokumentacionit ekzistues	3.00 €

2.9. Kompensimi (taksa) me rastin e dhënies së lejes ndërtimore për ndërtim bëhet ne bazë të Vendimit të Asamblesë Komunale sipas sipërfaqës Bruto të ndërtimit dhe atë brenda kufijve të PZHU, ndërsa jashtë kufirit të PZHU kompensimi të jetë më i ulët për 50% dhe vlen për të gjitha objektet ndërtimore si më poshtë:

- Objekteve Individuale të banimit
- Objekteve Individuale të banimit me afarizëm
- Objekteve Afariste

- Objekteve Industriale dhe Ekonomike (siloseve, depove, pishinave, Objekteve rekreative-sportive, tregu i kafshëve, tregu i automjeteve, tregu i gjelbër, parkingjet e tj.)
- Objekteve te Pompave për Karburante (hapësirave hyrëse dhe dalëse, sipërfaqet tjera përcjellëse dhe sipërfaqet e objektit)
- Objekteve Kolektive të Banimit me Afarizëm
- Objekteve Kolektive të Banimit

2.10. Për dhënien e aktit për:

Nr.		Shuma/€
1	Objekte Individuale të banimit	25.00€
2	Objekte kolektive të banimit	50.00€
3	Objekteve ekonomike	75.00€
4	Objekteve industriale	20.00€
5	Objekteve ndihmëse (Garazheve, Posllomeve e tj.)	20.00€
6	Objekteve të përkohshme	20.00€
7	Objekteve afariste – banesore	50.00€
8	Objekteve afariste	50.00€
9	Për vazhdimin e afatit të lejes së ndërtimit	50.00€
10	Për shëndrrimin e banesës nga banimi në lokal afarist	50.00€
11	Për shëndrrimin e afarizmit në banim	50.00€
12	Për Rrënimin e Objektit që ka leje ndërtimi	10.00€
13	Vërtetim për shtëpi të djegura për nevoja jashtë vendit	10.00€
14	Vërtetim për shtëpi të djegura për raste sociale-të lirohen nga pagesa	
15	Lëshimi i Referencave për punimet ku investitor është Komuna	10.00€
16	Lëshimi i Konstatimit për ekzekutimin e punimeve ku investitor është Komuna varësisht nga vlera e tërësishme e investimit	
	a) Investimi deri në 50.000 €	20.00€
	b) Investimi mbi 50.000 deri ne 100.000 €	30.00€
	c) Investimi mbi 100.000 €	50.00€

2.11. Shpenzimet për kompensimin e komisionit për kontrollimin dhe pranimin teknik të Projekteve - Drejtoria për Urbanizëm do ti caktoj me vendim të veçantë për çdo rast konkret

2.12. Nga kompenzimi për ndërtim lirohet Investitori i cili ndërton:

- * Objekt të karakterit social, shëndetësorë, arsimor ose fetar (jo profitabil)
- * Objekt banimi për zgjedhjen e çështjes së banimit të familjes së ngushtë të dëshmorit ose të invalidit të luftës.
- * Objekt në pronësi shtetërore për nevojat e interesit të përgjithshëm.
- * Është shoqatë humanitare dhe ndërton objekt për destinim humanitar.
- * Objekt investiv në pronësi Komunale me mjete financiare si donacione nga organizatat – shoqatat humanitare.
- * Objekte Bujqësore (Ferma – Stalla e tj)

2.13. Në raste kur kemi të bëjmë me ndërtimin nga ana e personave që nuk janë cekur më lartë, si p.sh. qendër rekreative apo ente shëndetësorë, atëherë duhet të merret leje e veçantë nga organi kompetent për lirim nga pagesa.

2.14. **Nëse lartësia e kompensimit për leje ndërtimore është mbi 50.000 € pagesa nga ana e investitorit mund të bëhet në tre këste dhe atë:**

- Kësti i parë përfshinë pagesën prej.....60%
- Kësti i dytë përfshinë pagesën prej.....20%
- Kësti i tretë përfshinë pagesën prej.....20% - obligimet duhet të përmbushen brenda një viti.

2.15. **Nëse lartësia e kompensimit për leje ndërtimore është mbi 100.000.00 € pagesa nga ana e investitorit mund të bëhet në katër këste dhe atë:**

- Kësti i parë përfshinë pagesën prej....40 %
- Kësti i dytë përfshinë pagesën prej....20 %
- Kësti i tretë përfshinë pagesën prej....20 %
- Kësti i katërt përfshinë pagesën prej..20 % -obligimet duhet të përmbushen brenda dy viteve.

2.16. **Pagesa e tarifave dhe ngarkesave për leje ndërtimi bëhet para marrjes së vendimit për lejimin e ndërtimit të objektit, kurse tarifat për kërkesë të pranimit teknik me rastin e dorëzimit të kërkesës.**

2.17. **Lartësia e tarifave për demolimin e objektit është:**

- Ngarkesa për demolimin e objektit të ndërtuar pa lejen e organit kompetent për punët e ndërtimit.....7 € / m² .
- Ngarkesa për rregullimin e pronës pas demolimit të ndërtimit pa leje nga organi kompetent për punët e ndërtimit8 € / m² .

2.18. **Për objektet e demolimit ngarkesat i bartë investitori, i cili nuk ka poseduar leje për ndërtim nga organi kompetent i Komunës për punët e ndërtimit .**

2.19. **Nga kompensimi për ndërtim lirohen nga pagesa me rastin e dhënies së lejes së ndërti:**

- *- Objektet publike siç janë:
(gjykatat, çerdhet e fëmijëve, objektet sakrale, objektet sportive, objektet shkollore-arsimore, komplekset (memoriale) për dëshmorët e Kombit, ndërtimet e varrezave dhe objektet përcjellëse, rikonstruimi i ndërtimeve të trashëgimisë kulturore dhe historike, pushimoreve për fëmijë, kopshteve zoologjike etj.

Neni 9

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Tarifa nr 3

Shfrytëzimi i pronës komunale me qëllime komerciale:

9.1 Qeraja për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, që do të paguhet nga shfrytëzuesi i pronës komunale do të përcaktohet sipas procedurës konkurruese

9.2 Normat për vendosjen e çmimit fillestar për një ankand publik apo ndonjë procedure tjetër të hapur konkurruese do ti jepen në një tabelë të veçantë dhe si të tilla kanë karakter sugjerues.

9.3 Shfrytëzimi i ndërtesave- lokaleve afariste që janë prone komunale bazohet në vlerën e qerasë e cila përcaktohet për metër katror (m^2) të cilat shfrytëzohen nga qiramarrësi varësisht se në cilën zonë ndodhet prona

a) **zona e parë (I)** : Përfshinë hapësirën e quajtur Ura e Dëmës- Deçan- Carrabreg i Epërm për të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës: Sheshin” Mentor Tolaj”, rrugën “Luan Haradinaj” rrugën “Dëshmorët e Kombit”, rrugën “Haki Povataj”, rrugën “Sali Çeku” dhe rrugën e “Manastirit”.

b) **zona e dytë (II)** : përfshinë hapësirën në të dy anët e rrugëve: “Mehmet Uka”, “Asim Vokshi”, “Brigada 131”, “Luigj Gurakuqi”, “Rruga e Demonstratave”, “Shaban Polluzha”, “Elena Gjika”, “Rrustem Bruqi”, “Dëshmorët e Deçanit”, “Bekim Berisha”, “Ulëza” dhe “Bedri Shala”

c) **zona e tretë (III)** përfshinë të gjitha hapësirat të cilat nuk janë të përfshira në zonën e I-re dhe të II-të e që i përkasin Qytetit të Deçanit.

1	Zona e parë	Lartësia e qerases mujore	€ m^2
2	Zona e dytë	Lartësia e qerases mujore	€ m^2
3	Zona e tretë	Lartësia e qerases mujore	€ m^2

9.4 Qeramarrësit të cilët nuk paguajnë qeranë për tre muaj detyrohen ta lirojnë lokalin afarist

Shërbimet tjera		
3.1	Kërkesë për vërtetim të pagesës së tatimit ne prone	
3.2	Tarifat për pajisje me leje për automjetet motorike ne baza vjetore	
3.3	Automjetet dhe taxi-automjetet deri në 3500 cm	
3.4	Automjetet dhe taxi-automjetet mbi 3500 cm	
3.5	Kamionët që bëjnë transportin e mallrave deri në 3.5 t	
3.6	Kamionët që bëjnë transportin e mallrave deri mbi 3.5 t	
3.7	Autobusë deri në 25 ulëse	
3.8	Autobusë mbi 25 ulëse (për çdo ulëse shtese)	

9.5 Nga tarifa e lejes për mjete motorike lirohen të gjitha automjete e emergjencës

Neni 10

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Tarifa nr 4

Përfshinë kontributet dhe detyrimet të cilat ofrohen nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Nr.		Shuma/ €
1	Vlerësimi i kushteve higjienike- epidemiologjike të kërkuara në teren	Personat fizik 10.0€
		Personat juridik 50.0€
2	Kërkesë për dhënien e pëlqimit sanitar	1.00€
3	Lëshimi i pëlqimit sanitar për lokale deri në $30m^2$	30.00€
4	Lëshimi i pëlqimit sanitar për lokale mbi $30m^2$ për çdo m^2	0.50€

5	Çdo certifikate ose vërtetim tjetër i cili nuk është parapare sipas tarifave	1.00€
6	Lëshimi i vërtetimit mbi izolimin dhe shkatërrimin e produkteve të caktuara nën mbikëqyrjen e inspeksionit sanitare paguhet :	
	a) Për artikuj ushqimore në sasi prej 10-1000 kg	30.00€
	b) Për artikuj ushqimore mbi 1000 kg plus për kg	0.15€
7	Për produkte farmaceutike dhe kozmetike e materie tjera kimike për kg	0.20€
8	Marrja e mostrave për analize me kërkesë të palës dhe procedim nga inspek. sanitar	20.00€
9	Përsëritja e mostrës për analize	10.00€
10	Ekzaminimi mjekësor në punkt,QMF, QKMF pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparature.	1.00€
11	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzime të mjekut familjar	2.00€
12	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzime të mjekut familjar	4.00€
13	Ekzaminimi në shtëpi përpos rasteve emergjente	6.00€
14	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar nga barnatorja publike	0.30€
15	Ultrazëri standard	2.00€
16	Radiografia	2.00€
17	EKG	0.50€
18	Analizat laboratorike- vetëm hemogrami dhe urina	1.00€
19	Analizat laboratorike (komplet)	3.00€
20	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00€
21	Audiograma	1.00€
22	Shpëlarja e veshit	1.00€
23	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përveç rasteve emergjente	1.00€
24	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përveç rasteve emergjente	1.00€
25	Përpunimi i plagës me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës(vetëm në vizitën e parë)	3.00€
26	Trajtimi ditor me infuzione në stacionin shëndetësor	1.00€
27	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	20.00€
28	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	15.00€
29	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit shëndetësor	5.00€
30	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive për një orë	25.00€
31	Vizita e parë stomatologjike	1.00€
32	RTG e dhëmbit	1.50€
33	Mbushje e përhershme me amalgamë	4.00€
34	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00€
35	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	5.00€
36	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	6.00€

37	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00€
38	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00€
39	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00€
40	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00€
41	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00€
42	Vulosja e fisurave	1.00€
43	Mënjanimi i depozitave të buta	1.00€
44	Mënjanimi i depozitave të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00€
45	Kiretazha e gjepave parodontal (një dhemb)	1.00€
46	Nxjerrja e dhëmbit	1.50€
47	Incizioni intra dhe extra oral	1.50€
48	Heqja e kurores me ane të prerjes	1.00€
49	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50€

Neni 11

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Tarifë nr. 5.

Nr.	Shërbimet	Shuma/€
1	Certifikata për shitjen e produkteve bujqësore,në treg	25.00€

5.2	Vërtetimi për transportin e kafshëve, nga apo në territorin e Deçanit	
1	Për çdo krerë gjedhi	2.00€
2	Për çdo krerë të kafshëve të imta	1.00€
3	Për çdo shpezë të ekspozuar në treg,për shitje	0.05 €
4	Vërtetimi për gjendjen shëndetësore të shpezëve që barten jashtë Kosovës	1.00€
5	Vërtetimi për gjendjen shëndetësore të qenve dhe maceve	3.00€

5.3	Kompensimi i shëndrimit të tokës bujqësore,në tokë ndërtimore-ind.	
1	Për klasën e parë për m2	1.50 €
2	Për klasën e dytë për m2	1.20€
3	Për klasën e tretë për m2	0.90€
4	Për kategorizim tjetër për m2	0.60 €

5.4	Për shërbime tjera	
1	Për lëshimin e çdo vërtetimi e që nuk është paraparë me këto tarifa	2.00€
2	Vërtetimi për të dëshmuar pronësinë e mekanizmit bujqësor	1.00€
3	Vërtetimi se një subjekt fizik merret apo është marrë me aktivitete bujqësore	2.00€

- 11.1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë do të dënohen me 50 € edhe atë:
- a) për ekspozim dhe shitje të produkteve të mishit dhe qumështit jashtë lokalit,
 - b). për ekspozim dhe shitje të produkteve të mishit dhe qumështit një ditë në vitrina që nuk kanë klimatizim,
 - c). shitja e të gjitha llojeve të produkteve dhe nënprodukteve të mishit dhe produkteve tjera ushqimore industriale – teknologjike që paraqesin rrezikshmëri

për shkak të kushteve jo adekuate (klimatiko – biologjike) jo në treg
d) . Skarat lëvizëse që janë të vendosura jashtë lokaleve për shkak të mosplotësimit të kushteve higjieniko – sanitare, mikrobiologjike termike etj,
e). ndalimi i shitjes i të gjitha llojeve të derivateve të naftës si psh: vajrat e ndryshme, plehrat artificial, etj, nëpër objektet që merren dhe me distribuimin
f). Të gjitha objektet shërbyese (qebaptoreset, restorantet, gjellëtoret, kuzhinat e ndërmarrjeve, bukëpjekësit etj) për mospajisje me certifikatën mbi shëndetshmërinë e mishit.

11.2. Për shitjen e mallit (mishit, qumështit dhe produkteve të ndjeshme ndaj kushteve klimatike të ambientit të jashtëm) jashtë objekteve, subjekti (fizik dhe juridik) do të dënohet me 100 €.

11.3. Mallrat dhe artikujt e ndryshëm ushqimor të cilave iu ka skaduar afati i përdorimit, do të konfiskohen nga ana e inspeksionit dhe shpenzimet e asgjësimit do t'i bartë subjekti afarist, në mbështetje të procesverbalit për konfiskim.

11.4. Dënohen me 50 % të vlerës së përgjithshme të shëndrrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore – industriale (varësisht nga kategoria e tokës) të gjithë ata persona të cilët në ngastrën bujqësore kanë ndërtuar objekte të ndryshme, por nuk kanë bërë shndërrimin e të njëjtave në tokë ndërtimore – industriale, në përputhje me vendimin që do të nxirret nga Kuvendi Komunal.

11.5. Dënimi prej 50 % të vlerës së shëndrrimit të ngastrës bujqësore në ngastër ndërtimore – industriale do të llogaritet si paradhënie (avans) nëse personi brenda vitit kalendarik e bënë legalizimin e njëjtë, konform dispozitave ligjore.

Neni 12 Drejtoria për Shërbime Publike

Tarifa nr. 6 përfshinë gjobat për kundravajtje të personave fizik dhe personave juridik kontributet dhe ngarkesat e ofruara nga Drejtoria për MSH dhe SHP, si vijon:

Tarifë nr. 6.

Nr.		Shuma/€
1	Për Kyçe pa leje në sistemin e ujës-jellësit apo te kanalizimit;	
2	Personi fizik	300.00€
3	Personi juridik	1000.00€

6.2	Për Ndotje te ambientit nga ujërat e zeza:	Shuma/€
1	Personi fizik	50.00€
2	Personi juridik	200.00€

6.3	Për Ndërhyrje pa leje në infrastrukturën e rrugëve:	Shuma/€
1	Personi fizik	300.00€
2	Personi juridik	800.00€

6.4	Per ndotje te ambientit me mbeturina	Shuma/€
1	Për ndotje të ambientit nga mbeturinat dhe materialet tjera jashtë deponisë së qytetit me automjete	300.00€

2	Për hedhjen e mbeturinave në sipërfaqe publike	100.00€
---	--	---------

6.5	Për keqpërdorimin e ujit të pijshëm:	Shuma/€
1	Personi fizik	50.00€
2	Personi juridik	300.00€
3	Uzurpimi i trotuareve përball hoteleve, shitoreve, punëtorive, enteve dhe institucioneve të ndryshme	200.00€
4	Shitësit e rrugëve në vendet jashtë vendeve të destinuara për shitje	50.00€

6.6. Për gërvishtjen, prerjen, lakimin, ndotjen ose dëmtimin në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë: Kabinat telefonike, ndriçimi publik dhe shenjat e komunikacionit shqiptohet gjoba:

Nr.		Shuma/€
1	Personi fizik	100.00€
2	Personi juridik	300.00€
3	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe (këputja e degëve, gjetheve etj.) për person	30.00 €
4	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtimet tjera)	20.00€
5	Hedhja e mbeturinave nga kalimtarët jashtë vendeve të caktuara	10.00€
6	Për mos respektimin të vendit në lokacionin e tregut	25.00€

6.7	Për larjen e veturave dhe automjeteve të tjera në trotuar dhe rrugë	
1	Personi fizik	25.00€
2	personi juridik	100.00€

6.8	Lejet për prerje të hapësirave publike	
1	Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuar 1m ²	100.00€
2	Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve etj. 1m ²	30.00€

Kërkuesi i lejes sipas këtij numri tarifar është i obliguar ta bëjë hapjen e kanalit, vendosjen e gypit apo instalimit tjetër nëntokësor, shënjimin e te njëjtë me shirit përkatës sigurie si dhe mbulimin e gypit me zhavorr, në trashësi deri 20cm mbi gyp apo instalim tjetër.

Nr.		Shuma/€
6.9	Procesi mbi plotësimin e kushteve teknike për AUTO-TAXI	
1	Për 5 ulëse	5.00€
2	Për 9 ulëse - minibusët	8.00€
3	Për autobus dhe mjete tjera të rënda	25.00€
4	Pëlqimi për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar për m ² ne dite	0.10 €
5	Veturat 24 orë	2.00€

6.10	Qëndrimi i automjeteve të konfiskuara nga policia	Shuma/€
1	Kombit, traktorët, dhe kamionetat për 24 orë	5.00€
2	Kamionët dhe autobusët për 24 orë	15.00€
3	Parkingjet e rezervuara në parkim të menaxhuar nga komuna për 1 muaj	40.00€
4	Parkingu kohor në parkingjet e menaxhuara nga komuna, për 1orë	0.50 €

6.11	Vendosja e mjeteve për akullore dhe mjete tjera të ngjashme për 1 muaj:	Shuma/€
1	Zona I për aparat	20.00€
2	Zona II për aparat	15.00€
3	Zona III	10.00€

6.12	Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor caktohet tarifa	Shuma/€
1	Zona I	20.00€
2	Zona II	15.00€
3	Zona III	10.00€

6.13	Ekspozimi i panove reklamuese në qytet - tarifa vjetore	Shuma/€
1	Zona I për m ²	30.00€
2	Zona II për m ²	20.00€
3	Zona III për m ²	10.00€
4	Panot reklamuese me ndriçim paguhet me tarifë të shtuar për 30%	

6.13.5 Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike - ekspozimi (reklamimi) për 1 m² 10.00

6.13.67. Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak se 30 ditë, shtohet vlera për 50%

Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm.

6.14	Qiraja për shfrytëzim të objekteve në pronësi komunale do të llogaritet në baza mujore sipas çmimit fillestar për 1m²:	Shuma/€
1	Objektet në zonën e parë	6.00 €/m ²
2	objektet në zonën e dytë	5.00 €/m ²
3	Objektet në zonën e tretë	4.00 €/m ²
4	Objektet në zonat rurale	2.00 €/m ²
5	Pronat e tilla duhet të lëshohen me qira përmes ankandit publik.	

6.15 Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme (kioskat, barakat dhe objektet tjera të përkohshme) kompensimi për 1m² në muaj është:

6.15	Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme (kioskat, barakat dhe objektet tjera të përkohshme) kompensimi për 1m² në muaj është:	Shuma/€
1	Bodrumi në Pallatin e Kulturës “J.Gërvalla”	1.50 € për m ² .
2	Përdhesa në Pallatin e Kulturës	3.00 € për m ²
3	Kati i parë në Pallatin e Kulturës	2.00 € për m ² .

4	Kati i dytë në Pallatin e Kulturës	2.00 € për m ² .
5	Për zonën e parë	4.00 €/m ²
6	Për zonën e dytë	3.50 €/m ²
7	Për zonën e tretë	2.50 €/m ²
8	Për vendet rurale	1.50 €/m ²
9	Qiraja vjetore për garazhet e vendosura në pronën komunale është	60 €

6.16.	Për shfrytëzimin e hapësirës publike para lokaleve të subjekteve afariste pas lëshimit se lejes nga organi kompetent i administratës , kompensimi mujor për 1m² është	Shuma/€
1	Për zonën e par	4.00 €/m ²
2	Për zonën e dytë	3.50 €/m ²
3	Për zonën e tret	3.00 €/m ²
4	Për vendet rurale	2.00 €/m ²

6.17. Nga shërbimet të cilat ofrohen nga lëmi i shërbimeve publike lirohen qytetarët e hendikepuar, personat të cilët kanë statusin e invalidit të punës dhe të luftës, dhe personat, shoqatat dhe institucionet qeveritare e joqeveritare, të cilët kanë ofruar donacione ose forma tjera të ndihmës. Kjo mund të vërtetohet me dëshmi përkatëse të cilën e ofron kërkuesi i shërbimit

Neni 13

Drejtoria për Inspekcione

Tarifa nr.7 përfshinë taksat që paguajnë subjektet afariste për dhënien e licencës për plotësimin e kushteve minimale higjieniko-teknike dhe të mbrojtjes në punë që lëshohet nga komisioni përkatës si vijon

Nr.		Suma/€
1	Objektet industriale	100.00€
2	Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzinës)	100.00€
3	Restorantet, hotelet dhe motelet a) hotelet deri 200 m ²	100.00€
	b) hotelet mbi 200 m ²	200.00€
4	Ordinancat, barnatoret dhe laboratorët bio-kimike	100.00€
5	Barnatoret bujqësore	75.00€
6	Vetëshërbimet : a) deri më 100m ²	75.00€
	b) 100 m ² deri 200 m ²	100.00€
	c) Mbi 200m ²	200.00€
7	Kuzhinat (gjellëtoret)dhe qebaptoret	75.00€
8	Ëmbëltoreset, kateterit, byrektoret	75.00€
9	Dyqanet tregtare të pavarura	50.00€
10	Dyqanet e pavarura zejtare	50.00€
11	Zyret dhe agjencitë	50.00€
12	Kiosqet	25.00€
13	Të tjerat të cilat nuk janë të përfshira në këtë numër tarifor	50.00€

Neni 14

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Tarifa nr. 8

Nr.		Shuma/€
1	Taksë për ushtrimin e veprimtarisë afariste (aplikohet në baza vjetore)	
2	Tregtia me shumicë e lëndëve të lëngta, gazëta	300.00€
3	Veprimtaritë zbavitëse: bixhozi dhe të vënit bast	2,000.00€
4	Tregtia me shumicë e pijeve alkoolike dhe pijeve të tjera	300.00€
5	Tregtia me shumicë e duhanit të përpunuar	300.00€
6	Restoranet me klube nate	1,000.00€

8.2	Tarifa për zgjatjen e orarit të punës	Shuma/€
1	Qebaptore, kafeteri , dyqane tregtare, ushqimore dhe te ngjashme;(për 1 orë)	5.00€
2	Supermarkete , dyqanet mëdha tregtare (për 1 orë)	20.00€
3	Veprimtari hoteliere (hotel, motel, restaurant, diskoklub); (për 1 orë)	20.00€
4	Veprimtari hoteliere (hotel, motel, restaurant, disko klub për (1 muaj)	200.00€
5	Qebaptore, kafeteri, supermarkete, dyqane tregtare, ushqimore dhe te ngjashme; (1 muaj)	100.00€
6	Supermarkete , dyqanet mëdha tregtare (për 1 muaj)	200. 00€

8.3	Shërbime /kërkesa tjera	Shuma/€
1	Kërkesë për vërtetim për stazh pune dhe vërtetim për konfirmim të Përvojës së veprimtarisë	2.00€
2	Kërkesë për vërtetim që familja nuk posedon biznes (për Bursë studentore)	2.00€
3	Kërkesë për vërtetim përposedim të biznesit personal/familjarë për qëllim Të marrjes së Vizës	2.00€
4	Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale	0.00€
5	Pëlqimi për hulumtimin dhe shfrytëzimin e mineraleve	0.00€

8.4	Shërbimet e Qendrës Komunale e Biznesit(përcaktuar me U.A. Nr.18/2011 ARBK)	Shuma/€
1	Regjistrim i Biznesit Individual - B.I	0.00
2	Regjistrimi i Shoqërisë me Përgjegjësitë Kufizuar	0.00
3	Regjistrim i Shoqërisë Aksionare - SH. A.	0.00
4	Regjistrim i Ortakëri e përgjithshme - O. P.	0.00
5	Regjistrimi i Shoqërisë komandite - Sh. K	0.00
6	Regjistrim i Kooperativave bujqësore	0.00
7	Regjistrim i Shoqërisë së Huaj	0.00
8	Ndërrimi i Emrit të Biznesit Individual	0.00
9	Ndërrimi i Emrit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
10	Ndërrimi i Emrit të Shoqërisë Aksionare	10.00
11	Ndërrimi i Emrit të Ortakërisë së përgjithshme	0.00
12	Ndërrimi i Emrit të Shoqërisë Komandite	0.00
13	Ndërrimi i Emrit të Shoqërisë së Huaj tregtare	10.00
14	Ndërrimi i Adresës se Biznesit Individual	0.00
15	Ndërrimi i Adresës së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
16	Ndërrimi i Adresës së Shoqërisë Aksionare	10.00
17	Ndërrimi i Adresës së Ortakërisë te përgjithshme	0.00

18	Ndërrimi i Adresës së Shoqërisë Komandite	0.00
19	Ndërrimi i Adresës së Shoqërisë së Huaj Tregtare	10.00
20	Ndërrim/Shtim i njësisë për Biznesit Individual	5.00
21	Ndërrim/Shtim i njësisë për Ortakëri	5.00
22	Ndërrim/Shtim i njësisë për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
23	Ndërrim/Shtim i njësisë për Shoqërinë e Huaj Tregtare	10.00
24	Ndërrim/Shtim i njësisë për Shoqërisë Aksionare	10.00
25	Ndërrim/Shtim i njësisë për Shoqëri Komandite	10.00
26	Shtim i aktivitetit për Biznesit Individual	0.00
27	Shtim i aktivitetit për Ortakëri	0.00
28	Shtim i aktivitetit për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
29	Shtim i aktivitetit për Shoqërinë e Huaj Tregtare	10.00
30	Shtim i aktivitetit për Shoqërisë Aksionare	10.00
31	Shtim i aktivitetit për Shoqëri Komandite	10.00
32	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Biznesit Individual	0.00
33	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Ortakëri Te përgjithshme	0.00
34	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
35	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Shoqërinë e Huaj Tregtare	10.00
36	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Shoqërisë Aksionare	10.00
37	Ndërrim/Shtim i punëtorëve për Shoqëri Komandite	10.00
38	Ndërrim/Shtim i kapitalit për Ortakëri	10.00
39	Ndërrim/Shtim i kapitalit për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
40	Ndërrim/Shtim i kapitalit për Shoqërinë e Huaj Tregtare	10.00
41	Ndërrim/Shtim i kapitalit për Shoqëritë Aksionare	10.00
42	Ndërrim/Shtim i kapitalit për Shoqëri Komandite	10.00
43	Ndërrim/Shtim i drejtorit për Ortakëri	0.00
44	Ndërrim/Shtim i drejtorit për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	00.00
45	Ndërrim/Shtim i drejtorit për Shoqërinë e Huaj Tregtare	0.00
46	Ndërrim/Shtim i drejtorit për Shoqërinë Komandite	0.00
47	Ndërrim/Shtim i drejtorit për Shoqërisë Aksionare	0.00
48	Ndërrim/Shtim i agentit të regjistruar për Ortakëri të përgjithshme	0.00
49	Ndërrim/Shtim i agentit të regjistruar për Shoqërinë me Përgjegjësitë Kufizuar	0.00
50	Ndërrim/Shtim i agentit të regjistruar për Shoqërinë e Huaj Tregtare	0.00
51	Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale	
52	Ndërrim/Shtim i agentit të regjistruar për Shoqëri Komandite	0.00
53	Ndërrim/Shtim i agentit të regjistruar për Shoqërisë Aksionare	0.00
54	Ndërrim/Shtim i aksionarëve për Ortakëri të përgjithshme	0.00
55	Ndërrim/Shtim i aksionarëve për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar	10.00
56	Ndërrim/Shtim i aksionarëve për Shoqërinë e Huaj Tregtare	10.00
57	Ndërrim/Shtim i aksionarëve për Shoqërisë Aksionare	10.00
58	Shuarja e Biznesit Individual	0.00
59	Shuarja e Ortakërisë të përgjithshme	0.00
60	Shuarja e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	0.00
61	Shuarja e Shoqërisë së Huaj Tregtare	0.00
62	Shuarja e Shoqërisë Aksionare	0.00
63	Shuarja e Shoqërisë Komandite	0.00
64	Certifikata e re e Biznesit	2.00
65	Vërtetimi për pronarët dhe drejtorët	2.00
66	Vërtetimi i kopjes si kopje autentike/(përfaqe)	1.00

67	Dorëzimi i informatave detale për biznesin/(përfaqe)	0.30
----	--	------

Neni 15

Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Taksat – tarifat për shërbime të Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi janë të përcaktuara në baze të : Udhëzimi Administrativ nr. 05/2012 MMPH për tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga zyra kadastrale dhe kompanitë gjeodete të licencuara, dhe Udhëzimit Administrativ nr. 08/2014 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme nga zyret kadastrale komunale.

Tarifë nr. 9

9.1	Ndërrimi i kulturave kadastrale	Shuma/€
1	Ndërrimi i kulturës në një ngastër pa matje	10.00
2	Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	5.00
3	Ndërrimi i kulturës në një ngastër me matje	35.00

9.2	Ndarja e ngastrave	Shuma/€
1	Ndarja e një ngastre në dy pjesë me sipërfaqe deri në 0.50 ha	60.00
2	ndarja e një ngastre në dy pjesë me sipërfaqe mbi 0.50 ha	100.00
3	Për çdo pjesë tjetër	25.00
4	Ndarja e ngastrës në pjesë në pjesë të përcaktuara më pare	100.00
5	ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më pare, çdo pjesë tjetër	35.00
6	Ndarja e një ngastre në dy pjesë me matje të pjesës së re dhe ripërtirje të kufijve	100.00
7	Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	25.00

9.3.	Rilevimi I ndërtesave	Shuma/€
1	Ndërtesat individuale – për një ndërtesë	50.00
2	Për çdo objekt tjetër në të njëjtën ngastër	20.00
3	Ndërtesat shumëkatëshe – për një ndërtesë, ekonomike, plan. parc	100.00
4	Objektet më të vogla që I takojnë ndërtesës shumëkatëshe – për një objekt	40.00
5	Ndërtesat me formë jo të rregullt me më tepër se 4 pika) – për çdo pike plus	10.00

9.4.	Përtrirja e kufijve të ngastrës	Shuma/€
1	Për ngastrën me sipërfaqe gjerë në 0.50 ha	80.00
2	Për ngastrën me sipërfaqe prej 0.50 ha gjerë 1.00 ha	100.00
3	Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te plus	50.00
4	Për rrugë, hekurudhë, kanale në gjatësi gjerë në 100m	150.00
5	Për çdo metër gjatësi shtesë – edhe	0.50

9.5	Punët në matje sipas kërkesave të posaçme	Shuma/€
1	Bartja e planeve urbanistike në teren – për një ngastër	80.00
2	Puna në zyre për ndarjen e ngastrës sipas planeve urbanistike – për një ngastër	20.00
3	Shënimi I vijës së rregullacionit të rrugës – për 1 metër gjatësi	0.50

9.6	Shënimi I kufijve në teren me rastin e eksproprijimit	Shuma/ €
1	Shënimi dhe matja e kufijve – për 1 metër gjatësi	0.80

9.7	Identifikimi I ngastrave dhe objekteve kadastrale në zyre	
1	Identifikimi i numrave të ngastrave dhe pronarëve për një ngastër	10.00
2	Për çdo ngastër tjetër plus	5.00
3	Identifikimi i një ngastre pa matje – për një ngastër	15.00
4	Identifikimi i një parcele – krahasimi I gjendjes së re me të vjetrën(në zyre)	30.00

9.8	Punët tjera gjeodete	Shuma/ €
1	Përpilimi i skicave për strukturën e banesës – ndërtesës	40.00
2	Matja e gypave, përçuesve elektrik dhe përçojave tjera – për një metër gjatësi	0.80
3	Koordinatat, lartësia mbidetare, përshkrimi i pozitës, çmimi për një pikë	10.00
4	vendosja e një pike gjeodezike (stacion i lire)	30.00
5.	Për çdo pikë tjetër edhe nga	10.00

9.9	Kopja e planit kadastral me paraqitje vertikale	Shuma/ €
1	Për planin me shkallë 1:1500	25.00
2	Për planin në shkallë 1: 1000	30.00
3	Për planin në shkallë 1.2500	30.00
4	Për planin në shkallë 1:5000	25.00

9.10.	Shërbimet administrative	Shuma/ €
1	Lëshimi I fletave poseduese, për fletën e pare	3.00
2	Ndërsa për çdo fletë tjetër të fletës poseduese	1.00
3	Certifikata (për një ekstrakt)	2.00
4	Regjistrimi, ndërrimi (bartja) apo fshirja e poseduesit të ri apo të drejtave mbi palujtshmerit	20.00
5	Kopja e planit formati A4 (për një kopje)	5.00
6	Kopja e planit formati A3 –(për një kopje)	7.00

9.11.	Punët tjera sipas kërkesave të palëve të cilat janë të përfshira në pikat e lartshënuara.	Shuma/ €
1	Puna në zyre për një orë	10.00
2	Puna në teren për një orë	30.00

9.12	Regjistrimi i pronësisë, posedimit, ne baze te transaksioneve (shitblerjes)	Shuma/ €
1	Për vlerën e transaksionit deri ne 10.000 €	20,00 €
2	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € deri ne 30.000 €	30,00 €
3	Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € deri ne 50.000 €	35,00 €
4	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € deri ne 100.000 €	50,00 €
5	Mbi vlerën e 100.000 €, për çdo 50.000 € tejkalim paguhet vlera prej 30,00 € por shuma e taksës se përgjithshme nuk mund ta tejkaloj vlerën e	300,00 €.
6	Poqese vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme	70,00 €

9.13	Regjistrimi i pronësi ne baze te dokumentit mbi dhuratën	Shuma/ €
1	Nëse ne dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës se paluajtshme është e caktuar vlera e pronës, ne këto raste paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues qe fiton drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit , sipas tarifës se përcaktuar ne 9.12 (1, 2, 3, 4 dhe 5). Në raste kur dhuratëdhënësi dhe dhuratëmarrësi janë anëtarë të familjes vetëm 30% e vlerave e cekura më lartë.	
2	Nëse ne dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës se paluajtshme nuk është e caktuar vlera e pronës, për çdo pronar- posedues qe fiton te drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit	40.00
3	Nëse në dokumentin(kontratën), mbi dhurimin e pronës së palujshme nuk është caktuar vlera e pronës, për çdo pronarë- posedues që fiton drejtën mbi pronën e palujshme sipas dhurimit , etë cilit janë anëtar të familjes do të paguajnë nga Në të kundërtën e kësaj kur pala kontraktuese nuk janë anëtar të familjes do të paguajnë shumën prej	50.00 80.00

9.14	Regjistrimi i pronësisë, posedimit ne baze te dokumentit te organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e te drejtës se pronësisë-posedimit	Shuma/ €
1	Regjistrimi i te drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet ne baze te Vendimit te organeve administrative apo gjyqësore	50.00

9.15	Regjistrimi i pronësisë-posedimit ne baze te pjesëtimit (ndarjes) te pronës ne bashkëpronësi	Shuma/ €
1	Regjistrimi i pronës-posedimit ne baze te pjesëtimit (ndarjes) te pronës ne bashkëpronësi, për secilin person qe behet pronar- posedues	20,00 €
2	Regjistrimit i pronës së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi do të paguhet në shumë prej :	20.00 €
3	Regjistrimit i pronës së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi për të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta do të paguhet në shumë prej	100.00€
4	Për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve do të paguhet tarifa prej	20.00€

9.16	Regjistrimi i pronës-posedimit, ne baze te Trashëgimisë dhe shkëputjes se bashkësisë familjare.	Shuma/ €
1	Regjistrimi i pronësisë-posedimit ne baze te Trashëgimisë, për çdo trashëgimtar	10,00 €
2	Regjistrimi i pronësisë – posedimit ne baze te shkëputjes se bashkësisë familjare, për çdo anëtar te familjes qe behet pronar- posedues	10,00 €

9.17	Regjistrimi i pronësisë-posedimit, ne baze te ndërrimit te pronësisë se paluajtshme	Shuma/ €
1	Regjistrimi i pronësisë-posedimit ne baze te ndërrimit te ndërrimit te pronës se paluajtshme, për secilin pronar-posedues	30,00 €

9.18	Regjistrimi i hipotekave	Shuma/ €
1	Kërkesa (kredia) ne vlerën deri 10.000 €	10,00 €

2	Kërkesa (kredia) ne vlerën prej 10.000 € deri ne 30.000 €	20,00 €
3	Kërkesa (kredia) ne vlerën prej 30.000 € deri ne 50.000 €	30,00 €
4	Kërkesa (kredia) ne vlerën prej 50.000 € deri ne 100.000 €	80,00 €
5	Mbi vlerën e 100.000 €, për çdo 100.000 € tejkalim paguhen edhe nga 30,00 € por shuma e taksës nuk mund te tejkaloj vlerën e	400,00 €.

9.19	Fshirja e hipotekave	Shuma/ €
1	Për Vendimin lidhur me fshirjen e Hipotekës nga Regjistri i te Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme	10,00 €

9.20	Regjistrimi i servituteve	Shuma/ €
1	Regjistrimi i te drejtës se Servitutit ne Regjistrin e te Drejtave mbi pronën e Paluajtshme	50,00 €
2	Fshirja e Servitutit nga regjistri	20,00 €

9.21	Regjistrimi i te drejtës se shfrytëzimit-Qirambajtja	Shuma/ €
1	E drejta e shfrytëzimit-qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri ne 10 vite	50,00 €
2	E drejta e shfrytëzimit-qirambajtje me kohëzgjatje prej 10 deri ne 25 vite	150,00 €
3	E drejta e shfrytëzimit-qirambajtje me kohëzgjatje deri ne 99 vite	500,00 €
4	Fshirja e te drejtës se shfrytëzimit-qirambajtja behet duke paguar 20 % të shumës qe është paguar për regjistrimin e te drejtës se shfrytëzimit	
5	Më rastine bartjës së të drejtës së qirambajtjes të shfrytëzimit do të aplikohet tarifa si në nenin 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativë të AKK-së	
6	Korrigjimi i të dhënave të cilat janë futur sipas dokumentacionit të dorëzuar do të paguhet tarifa prej. Nëse gabimi i të dhënave është si pasoj e veprimeve të drejtorisë, pala do të lirohet nga pagesa.	20.00€

9.23	Regjistrimi i te drejtave tjera	
1	Regjistrimi i te gjitha te drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme që nuk janë përfshi në këtë numër tarifor	40,00 €

Neni 16 Drejtoria për Arsim

Taksat dhe tarifrat do te përcaktohen gjate konsultimit me drejtorin dhe personelin e kësaj drejtorie gjate periudhës kur kjo rregullore do ti nënshtrohet diskutimit publik.

Neni 17 Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport

Taksat dhe tarifrat do te përcaktohen gjate konsultimit me drejtorin dhe personelin e kësaj drejtorie gjate periudhës kur kjo rregullore do ti nënshtrohet diskutimit publik.

Neni 18
Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare

Të gjitha taksat, ngarkesat, tarifat dhe gjobat komunale qe nuk janë te parapara ne këtë Rregullore, do te aplikohen taksat te cilat jenë te parapara me Udhëzimet Administrative dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 19

Çdo ndryshim, plotësim apo azhurnim i kësaj rregullore, automatikisht duhet te jete pjesë e kësaj Rregulloreje.

Neni 20

Me këtë rregullore shfuqizohet Rregullorja për Caktimin e Lartësisë së Taksave dhe ngarkesave për Shërbimet Komunale, Nr 01/XI-2 ,dt 13.01.2012.

Neni 21

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do te kujdesen sektoret e veçantë të Administratës Komunale kurse mbikëqyrja e zbatueshmërisë do te bëhet nga Kryetari i Komunës.

Neni 22

Kjo Rregullore hyn ne fuqi pas miratimit te sajë nga Kuvendi Komunal dhe pas plotësimit te kriterëve tjera te nevojshme procedurale.

Kuvendi i Komunës së Deçanit

Kryesuesi i Kuvendit

Jashar Dobraj